

**STATUT I SHOQËRISË TREGTARE  
TRIFOLIUM Sh.P.K.**

Në Tiranë, sot më datë 22 Qershor 2021, shtetasit:

**Znj. Najada Sotir Kambo**, e lindur më 19 Nëntor 1996, në Korçë dhe banuese në Rrugën Medar Shtylla, Komuna e Parisit, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtëse e Kartës së Identitetit me numër 032647736 dhe numër personal J66119056B madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Z. Ori Arben Hoxha**, i lindur më 7 Gusht 1994, në Tiranë dhe banues në Rrugën Isa Boletini, Nr.28, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtës i Kartës së Identitetit me numër 031587938 dhe numër personal J40807054B, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Z. Rexhino Gëzim Çekrezi**, i lindur më 01.10.1993 në Belsh dhe banues në Rezidencën Rolling Hills, Villa 11, Lundër, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtës i Kartës së Identitetit me numër 034528799 dhe numër personal J31001102S madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Z. Admir Baftjar Malaj**, i lindur më 17 Maj 1983, në Elbasani dhe banues në Sheshi Hari Trumen, Nd.1, H.42, Ap.5, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtës i Kartës së Identitetit me numër 034473513 dhe numër personal I30517102S, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Të cilët duke u bazuar dhe në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” dhe legjislacionin në Republikën e Shqipërisë, vendos/in të hartoj/ë këtë statut, i cili do të përfshijë dhe Aktin e Themelimit të Shoqërisë.

Në këtë statut përkufizohen si më poshtë:

- “Ligji” është Ligji 9901, datë 14 Prill 2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregëtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë;

**KREU I**

**THEMELIMI, EMRI, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

**NENI 1**

**Data themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më datë 22 Qershor 2021, Ortakët e shoqërisë, vendosën të themelojnë Shoqërinë tregtare me emër **TRIFOLIUM Sh.P.K** Tiranë, emërtimi i të cilës do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.

**NENI 2**

**Selia**

Selia e shoqërisë TRIFOLIUM Sh.P.K. është : Rruga Petro Nini Luarasi, P. Dolçka, K. II (Tek ish-Tregu Elektrik), Tiranë, Shqipëri.



### **Neni 3**

#### **Objekti**

3.1. Shoqëria TRIFOLIUM Sh.P.K. do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- i. Aktivitet në fushën e prodhimit, blerjes dhe shitjes së software (programeve kompjuterike dhe zgjidhjeve teknologjike nëpërmjet programimit), dizënim programim (kodim) dhe zhvillim, projektim i detajuar i faqeve web, aplikacioneve mobile, software dhe bazave të të dhënave, analizë, integrim i përbërësve (komponenteve), trajnime mbi produktet software, instalime, konsulenca, zbatime dhe aktivitete të tjera ndihmëse në fushën e teknologjisë dhe dixhitalizimit përtej industrisë përkatëse, ndjekje të proceseve, kolaudim, korrigjim, deri në produktin përfundimtar duke realizuar zgjidhje, plotësime të sistemit informatik me elementet e sigurisë, privatësisë etj.
- ii. Blerje dhe shitje të pajisjeve hardware, kompjutera, aksesorë dhe pjesë të tyre, instalim e mirembajtje të tyre.
- iii. Kurse profesionale, këshillim karriere, ndërmjetësim punësimi dhe shërbime të tjera të tregut të punës të lidhura kryesisht me fushën e shkencave kompjuterike dhe teknologjisë, por dhe më gjërë, në sektorë të tjerë përtej kësaj industrie.
- iv. Import dhe eksport të mallrave dhe shërbimeve sipas nënpikave i, ii dhe iii të pikës 3.1 të këtij neni.

3.2 Shoqëria për të arritur objektivat e përcaktuara mund të bashkëpunojë direkt dhe indirekt me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm dhe/ose të lidhur me të tyren.

### **NENI 4**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë do të jetë e *pacaktuar dhe/ose e pakufizuar*, duke filluar nga dita e regjistrimit në regjistrin tregëtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

### **KREU II**


#### **KAPITALI**

### **NENI 5**

#### **Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 Lekë (Njëqindmijë Lekë) dhe përbëhet e gjitha nga kapital në para. Pjesëmarrja e Ortakeve themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- i. Ortakuja themelues Znj. Najada Kambo zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 2,100 (Dy mijë e njëqind) Lekë që përben 2.1 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- ii. Ortaku themelues Z. Ori Hoxha zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 39,300 (Tridhjetë e nëntë mijë e treqind) Lekë që përben 39.3 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- iii. Ortaku themelues Z. Rexhino Çekrezi zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 29,300 (Njëzet e nëntë mijë e treqind) Lekë që përben 29.3 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.





iv. Ortaku themelues Z. Admir Malaj zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 29,300 (Njëzet e nëntë mijë e treqind) Lekë që përben 29.3 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

5.2 Kapitali themeltar perbehet nga 4 (Katër) kuota me vlerë nominale sipas pikës 5.1 të këtij neni dhe vlerë të përgjithshme prej 100,000 Lekë (Njëqindmijë Lekë) të marra sëbashku.

#### **NENI 6**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i Kapitalit**

6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, sipas legjislacionit në fuqi.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

6.2 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **NENI 7**

##### **Transferimi i kapitalit**

7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- i. kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- ii. shitblerjes;
- iii. trashëgimisë;
- iv. dhurimit;
- v. çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **NENI 8**

##### **Organi Vendimarrës**

8.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë. Ajo miraton çdo ndryshim të statutit sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

8.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- i. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ii. ndryshimet e statutit;
- iii. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- iv. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- v. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- vi. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- vii. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;





- viii. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ix. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- x. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- xi. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- xii. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- xiii. Shperndarjen e fitimeve vjetore.
- xiv. çështje të tjera të parashikuara nga ligjislacioni në fuqi apo statuti.

8.3 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

8.4 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme, përveçse në rastin kur ai është dhe ortak i vetëm i Kompanisë.

8.5 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## NENI 9

### Mënyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

9.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji, nga dispozitat e këtij statuti dhe sa herë është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit.

9.2 Asambleja e Përgjithshme thirret edhe në këto raste:

i. Nëse sipas bilancit vjetor, apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda tre muajve në vazhdim;

ii. Kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara;

iii. Kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara;

9.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë, me postë ose nëpërmjet postës elektronike, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashkruar për mbledhjen e Asamblesë.

9.3 Asambleja e Përgjithshme i zhvillon mbledhjet e saj dhe merr vendime vetëm kur realizohet kuotimi i përcaktuar në ligj.

9.4 Ortakët gëzojnë të drejtën e votës në përpjestim me kuotat që ata zotërojnë. Çdo kuotë ka të drejtën e një vote.

9.5 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal, i cili plotësohet sipas kërkesave të përcaktuara në ligj. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Në momentin që shoqëria do të publikojë një faqe në internet, administratori, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e mbledhjes, publikon kopje të procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme në këtë faqe.

9.6 Në momentin e krijimit të kushteve sipas ligjit, ortakët mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme edhe duke shfytëzuar mjetet elektronike.



## NENI 10

### Marrja e vendimeve

10.1 Ortakët e shoqërisë vendosin për të gjitha çështjet e tjera të renditura në këtë statut. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

10.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- i. përcaktimi i politikave tregëtare të shoqërisë;
- ii. emërimin e administratorëve;
- iii. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- iv. përcaktimin e shpërblimeve;
- v. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- vi. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- vii. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

10.3 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skendin e shoqërisë.

## NENI 11

### Përgjithshmi nga e drejta e votës

11.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- i. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- ii. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- iii. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- iv. dhënieve ose jo të përfitimeve të reja.

11.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## NENI 12

### Administrimi

12.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Si rregull, afati i emërimit është 3 (Tre) vjet me të drejtë ripërtëritjeje, ndërsa në momentin e themelimit, administratori i parë ka një mandat 6 (Gjashtë) mujor. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

12.2 Çdo emërim i bërë në kundërshtim me ligjin dhe këto dispozita është i pavlefshëm.

12.3 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i vetëm i shoqërisë për një mandat 6 (Gjashtë) mujor, me të drejtë ripërtëritjeje, emërimi: **Znj Najada Sotir Kambo**, e lindur më 19 Nëntor 1996, në Korçë dhe banuese në Rrugën Medar Shtylla, Komuna e Parisit, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtëse e Kartës së Identitetit me numër 032647736 dhe numër personal J66119056B madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.





## NENI 13

### Kompetencat e Administratorëve

13.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- i. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- ii. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- iii. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- iv. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- v. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- vi. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- vii. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme së ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- viii. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në këtë statut.

13.2 Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- i. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- ii. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- iii. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

13.3 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

13.4 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.

## NENI 14

### Përgjegjësitë e Administratorit

14.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

14.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

14.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", administratori detyrohet:

- i. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- ii. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- iii. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- iv. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- v. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

14.3 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve



kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

14.4 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

14.5 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, kryen veprimet e mëposhtme në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare":

i. u kthen ortakëve kontributet;

ii. u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

iii. u shpërndan aktivet shoqërisë;

iv. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

v. jep kredi.

14.6 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

14.7 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **KREU IV VITI FINANCIAR- EKSPERTET**

### **NENI 16**

#### **Viti Financiar**


Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### **Neni 17**

#### **Ekspertet**

17.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tilla i ngarkuar nga ana e ortakeve.

17.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.





**KREU V**  
**PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**NENI 18**

**Prishja dhe likuidimi**

18.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- i. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- ii. Me hapjen e procedurave të falimentimit.
- iii. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr.9723 datë 3.5.2006 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar;
- iv. Me vendim të gjykatës;

18.2 Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri në likuidim e sipër”.

18.3 Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese. Likuidimi i shoqërisë bëhet sipas përcaktimeve në ligjin “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**NENI 19**

**Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”.

**NENI 20**

**Baza Ligjore**

20.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

20.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë. Në çdo rast legjislationi në fuqi në Republikën e Shqipërisë prevalon mbi dispozitat e këtij statuti.

**NENI 21**

**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jete kompetente Gjykata e Rrethit Tiranë.

**NENI 22**

**Njoftimet**

Njoftimet për ortakët do të bëhen me postë, në adresën e fundit të komuikuar me çdo ortak. Në momentin e krijimit të kushteve, njoftimet bëhen edhe me postë elektronike.





**NENI 23**

**Dispozita te fundit**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me ligjin shqiptar.

Ky Statut u hartua ne 6 (Gjashtë) kopje, një kopje për Qendrën Kombëtare të Biznesit nje kopje Administratori dhe Ortakët. Ky statut u hartua ne gjuhen Shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortakët themelues si vijon.

**ORTAKËT**

**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**TRIFOLIUM Sh.P.K.**

**Znj. Najada Kambo**



.....

**Z. Ori Hoxha**




.....

**Z. Rexhino Çekrezi**



.....

**Z. Admir Malaj**



.....